



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

## NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti: Përftimi i kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re nga Porsche AG dhe Schuler AG.**

Përfaqësuesi ligjor i Porsche AG dhe Schuler AG, “CR Partners” me shkresën Nr. 493 Prot., datë 07.09.2018 “Përqendrimi ndërmjet Porsche AG dhe Schuler AG” ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës transaksionin e propozuar midis këtyre dy palëve. Porsche AG dhe Achuler AG synojnë krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët (*Joint Venture-IV*) në të cilën këto dy ndërmarrje do të ushtrojnë kontroll të përbashkët.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

**Pala 1: DR.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft**, është një shoqëri gjermane e themeluar në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit gjerman. Porsche është një prodhues gjerman i automjeteve, i specializuar në dizenjimin, prodhimin dhe shpërndarjen e makinave sportive, makinave Suv dhe Sedane. Porsche është pjesë e grupit Volkswagen, një shoqëri me ofertë publike, me seli në Gjermani. Grupi është aktiv në mbarë botën për zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave për transportin e pasagjerëve, makinave komerciale, kamionëve, autobusëve, trajlërve, shasive për autobusë dhe motorë benzine, motoçikleta, duke përfshirë edhe pjesë këmbimi për to. Kapitali themeltar i Porsche është 50.000.00 Euro<sup>1</sup>.

**Shqipëri:** Grupi është prezent përmes tre filialeve: Porsche Albania SHPK; Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Mobility SHPK.

*Porsche Albania SHPK*<sup>2</sup> regjistruar më 05.07.2005. Ortak i kësaj shoqërie është Porsche Holding Gesellschaft m.b.H me 100% të kuotave.

*Porsche Leasing SHPK*<sup>3</sup>, regjistruar më 23.04.2013. Ortakë i kësaj shoqërie është Porsche Bank Aktiengesellschaft me 100% të kuotave.

*Porsche Mobility SHPK*<sup>4</sup>, regjistruar më 23.04.2013. Ortakë i kësaj shoqërie është Porsche Bank Aktiengesellschaft me 100% të kuotave.

**Pala 2: Schuler Aktiengesellschaft**, është një shoqëri aksionare e themeluar në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit gjerman, aktiv në fushën e krijimit dhe prodhimit të makinave shtypëse te metaleve, proceseve të automatizuara, veglave,

<sup>1</sup> Burimi: Regjistri tregtar i Gjykatës për Porsche AG

<sup>2</sup> Burimi: Statuti i shoqërisë. Kapitali i shoqërisë është 707.911.000 lekë.

<sup>3</sup> Burimi: Statuti i shoqërisë. Kapitali themeltar është 69.950.000 lekë

<sup>4</sup> Burimi: Statuti i shoqërisë. Kapitali i shoqërisë është 69.950.000 lekë

përpunimit të mënyrës se si realizohet një proces dhe shërbimeve për gjithë industrinë e përpunimit të metaleve si dhe atë të ndërtimit të automjeteve të lehta. Schuler i përket grupit austriak Andritz. Kapitali i shoqërisë është 77.769.250,00 Euro<sup>5</sup>.

**Shqipëri:** Schuler në Shqipëri lidhet me instalimin, ndërtimin, mbikëqyrjen dhe komisionimin e pajisjeve mekanike për hidrocentrale përmes degës shqiptare të ADRITZ HYDRO GmbH për klientë të tillë si p.sh KESH dhe Energji Ashta.

*Andritz Hydro Branch Albania*, regjistruar më 08.02.2010. Ortakë i kësaj shoqërie është Andritz Hydro GmbH me 100% të kuotave.

**Shoqëria target: Joint Venture**, shoqëri komandite (Kommanditgesellschaft). Kuotat e partneritetit dhe të ortakut do të zotërohen nga palët njoftuese të përqendrimit në raportin 50% me 50%. Ky JV do të jetë një *Full Functioning Joint Venture* dhe do të ushtrojë funksionet e saj si një entitet i pavarur. JV do të ndërtojë një fabrikë në të cilën metalet p.sh, pjesët dhe fletët e çelikut dhe aluminit, formohen përmes shtypjes së tyre në përputhje me kërkesat specifike të klientëve.

Marrëveshja midis palëve është nënshkruar në 4 Shtator 2018, ndërmjet Dr. Ing. h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft. Nga dispozitat e marrëveshjes kuptohet se kemi të bëjmë me përfitim e kontrollit të përbashkët nga dy shoqëritë Porsche AG dhe Schuler AG mbi një shoqëri të re që këto dy kompani do krijojnë, shoqëri e cila do të jetë një *Full Functioning Joint Venture*. Kjo shoqëri do të funksionojë si shoqëri më vete dhe do ketë organet drejtuese dhe menaxhuese të saj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**

---

<sup>5</sup> Burimi: Regjistri tregtar i Schuler AG